2. Kur autoritetet /entet kontraktore vërejnë se oferta është anomalisht e ulët, i kërkojnë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin dhe në përputhje me dispozitat e këtij neni.

- Në rast kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët kur zvogëlohet më shumë se 25% të fondit limit të përllogaritur.

- Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më pak se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Nëse një ose disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, para se të marrë një vendim për kualifikimin e tyre ose jo, në përputhje me nenin 93 të LPP-së.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementet specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$$MO = O1 + O2 + O3 + \dots On / N$$

$$PR = 85 \% Mo$$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

- 23. Njoftimi i Fituesit**
1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.
- 24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës**
1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
 2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.
- Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:
- a) garanci bankare
 - b) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

- 25. Procedura e ankesës**
1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.
 2. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

- 26. Anulimi i procedurës**
1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
 2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të

rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve të Shërbimeve

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 7. Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 8. Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit

Formulari 12- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Pas procesit të ankimit)

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Pas procesit të ankimit)

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 8. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shënim:

- i) Operatoret ekonomike ofertues, krahas Formularit të Ofertes, duhet të paraqesin analizen e kostos për ofertën e paraqitur me përlogaritjet konkrete, në të cilën të jenë të përfshirë të gjitha detyrimet ligjore si: paga baze, shtesat mbi pagë Turni II, III, shtesa për një ditë feste, sigurimet shëndetësore dhe shoqërore, fitimin e shoqërisë, etj. Të gjitha ofertat ekonomike që nuk kanë përfshirë në masën e caktuar nga legjislati në fuqi, detyrimet e sipërcituara, do të skualifikohen.**
- ii) Një ofertues mund të aplikojë për [lotin I], [Lotin II], ose për të dyja Lotet bashkë, për çdo Lot paraqitet një ofertë e veçantë.**

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE): _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për shërbimet. Shërbimetpa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i shërbimit	Sasia	Çmimi për njësi	Çmimi total për shërbim (3 x 4X)	
1.	Loti I: Shërbimi privat i sigurisë fizike për një periudhë 3 vjeçare, për N/Stacionin Fierz, N/Stacionin Koman, N/Stacionin Vau Dejës, N/Stacionin Koplik, N/Stacionin Burrel dhe N/Stacioni Shumat (komplet)	1			
2.	Loti II: Shërbimi privat i sigurisë fizike për një periudhë 3 vjeçare, për N/Stacionin Tirana 1, N/Stacionin Tirana 2, N/Stacionin Sharrë, N/Stacionin Rrashbull, NJMT, Zyrat Qëndrore OST sh.a., N/Stacionin Elbasan 1, N/Stacionin Elbasan 2, Magazina Elbasan, N/Stacionin Zemblak, N/Stacionin Fier, N/Stacionin Babicë dhe Magazina Kuçovë (komplet)	1			
				Çmimi total (Mallrat)	_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 3.

[*Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik*]
[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

“Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike të objekteve të OST sh.a. për një periudhë 3 vjeçare”

Afatet e ekzekutimit:

1	Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike të objekteve të OST sh.a., për një periudhë 3 vjeçare			36 (tridhjetë e gjashtë) muaj nga hyrja në fuqi e marrëveshjes kuader
---	-----------------------------------------------------------------------------------------------	--	--	-----------------------------------------------------------------------

Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

I. Specifikimet teknike të kërkesave të zbatimit të shërbimeve:

- Personeli duhet të jetë i pajisur me kartë identiteti personale.
- Personeli Drejtues Teknik duhet të jetë i pajisur me Liçencë për Drejtues Teknik të Kategorisë 1.3A.
- Personeli duhet të jetë i liçensuar me lejet përkatëse nga Drejtoria e Policisë të Qarkut ku janë vendosur objektet, jo më pak se numri i rojeve që kërkohet për çdo vëndroje.
- Personeli duhet të jetë i pajisur me leje për përdorimin e armëve të zjarrit sipas kërkesave ligjore në fuqi, një leje për armë për çdo roje.
- Personeli duhet të jetë i pajisur me dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik, jo më pak se numri i rojeve që kërkohet për çdo vëndroje.
- Personeli duhet të jetë i pajisur me uniformë të pastër, të rregullt, të hekurosuar, verore dhe dimërore, ku të jetë e reklamuar stema e shoqërisë.
- Personeli duhet të jetë i pajisur me armë zjarri për kryerjen e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë.
- Personeli duhet të jetë i pajisur me mjetet e komunikimit radio dhe telefon, të domosdoshme për kryerjen e shërbimit.
- Personeli duhet të jetë i pajisur me mjetet e punës për parandalimin dhe zmbropsjen e dhunës.
- Personeli duhet të jetë i pajisur me librat për marrjen dhe dorëzimin e shërbimit.
- Personeli duhet të jetë i pajisur me librat e administrimit të armatim-municionit.
- Personeli duhet të jetë i pajisur me librat e hyrje - daljeve të vizitorëve, automjeteve dhe materialeve.
- Personeli kryen shërbim jo më shumë se 8 orë në 24 orë.

II. Termat e Referencës

Operatori ekonomik për të realizuar të gjitha objektivat e ruajtjes e të sigurisë të objekteve të Autoritetit Kontraktor merr masat për plotësimin me dokumentacion dhe realizimin e detyrave të mëposhtme:

1. Operatori ekonomik duhet të ketë Liçencë të Kategorisë 1.3A "Për sigurimin fizik objekteve shtetërore e private, i personave, si dhe veprimtarive social-kulturore, sportive, fetare e politike", e cila ushtrohet në të gjithë territorin e vendit të lëshuar nga DPPSH.
2. Operatori ekonomik siguron që personeli i tij, të jetë i pajisur me Çertifikatë të Punonjësit të Shërbimit nga Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut ku ndodhet objekti, jo më pak se numri i rojeve që kërkohet për një vëndroje. Operatori ekonomik paraqet një vërtetim të lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë, i cili përmban të dhëna për listën emërore të punonjësve të shërbimit të çertifikuar, vlefshmërinë e këtyre çertifikatave – datën e çertifikimit (data e lëshimit) dhe afatin e vlefshmërisë të kësaj çertifikate.
3. Operatori ekonomik paraqet dokumentacion ligjor të gjendjes gjyqësore të pastër gjatë dy viteve të fundit të njëpasnjëshme për arsye të veprimtarisë të saj dhe të personelit të saj punonjës.
4. Operatori Ekonomik siguron që në qarkun ku ndodhet objekti ka një Qendër Kontrolli Shërbimi të miratuar nga Drejtoria Vendore e Policisë së qarkut.
5. Operatori ekonomik siguron që personeli i tij, të jetë i pajisur me Autorizimin e Mbajtjes së Armës në Shërbim të lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë të Qarkut ku kryen shërbim.

6. Operatori ekonomik siguron që personeli i tij, të jetë i pajisur me Dëshminë e Kualifikimit për Sigurimin Teknik, jo më pak se numri i rojeve për çdo vëndroje.
7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizimin e lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare për përdorimin e radio frekuencave në zonën ku ndodhen objektet.
8. Operatori ekonomik duhet të ketë grup të gatshëm në çdo qark ku ndodhen objektet e Autoritetit Kontraktor të marra në ruajtje nga ai.
9. Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertë ekonomike bazuar në kostot ditore të kryerjes së shërbimit të ruajtjes me roje.
10. Roja duhet të jetë i pajisur me me uniformë, armë zjarri, mjete mbrojtëse dhe parandaluese, dokumentacionin përkatës dhe mjete të tjera logjistike sipas parashikimeve në ligjin nr. 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike".
11. Rojet, me udhëzimet e Sektorit të Sigurisë të Aktivitetit dhe Aseteve të Autoritetit Kontraktor dhe/ose në mënyrë të pavarur ndërmarrin masa për parandalimin dhe ndalimin e veprimeve që dëmtojnë personelin, aktivitetin dhe asetet e shoqërisë OST sh.a.
12. Gjatë ditës dhe natës rojet kryejnë kontrole çdo 15 minuta në zonat e tyre të përgjegjësisë në objektet ku kryejnë shërbim. Përgjithësisht të përgjithshëm nga ky rregull bëjnë vetëm rojet që kryejnë shërbim në hyrje të objekteve gjatë orarit 07:30 – 16:00.
13. Rojet që kryejnë shërbim në hyrje të objekteve në ruajtje zbatojnë me rigorozitet "Procedurat Standarte të Hyrje – Daljeve në OST sh.a." detyrat dhe udhëzimet e Sektorit të Sigurisë të Aktivitetit dhe Aseteve të Autoritetit Kontraktor në lidhje me mbrojtjen dhe sigurinë e objekteve.
14. Gjatë zhvillimit të aktivitetit të SHPSF-së në objektet e OST sh.a., për të gjitha dëmet e shkaktuara nga mosfunksionimi i rregullt i shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë dhe moszbatimi i procedurave të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues do të ç`dëmtohen nga SHPSF-ja.

Detyrat:

1. Shërbimi i sigurisë fizike të objekteve të OST sh.a. në Lotet I dhe II, do të kryhet në (12+25) **37 (tridhjetë e shtatë)** vëndroje, me tre turne gjatë 24 orëve, në shtatë ditë të javës dhe në zbatim të Kodit të Punës jo më shumë se 40 orë pune në javë (8orë në ditë) për roje.
2. SHPSF-ja kontraktore parandalon dhe ndalon me të gjitha mjetet në dispozicion hyrjen e paautorizuar të individëve, automjeteve dhe materialeve në objektet në ruajtje.
3. SHPSF-ja kontraktore duhet sigurojë kontrollin e vazhdueshëm të perimetrit të brendshëm të objektit në ruajtje dhe zonën e interesit jashtë rrethimit të objektit gjatë ditës dhe natës.
4. SHPSF-ja kontraktore kryen kontrollin fizik të individëve, automjeteve dhe materialeve në hyrje dhe dalje të objekteve në ruajtje dhe kryen evidentimet përkatëse në dokumentacion për këtë qëllim.
5. SHPSF-ja kontraktore çdo fillim muaji paraqet grafikun e shërbimit të personelit roje në objekte dhe njofton paraprakisht me shkrim ose e-mail në Sektorin e Sigurisë të Aktivitetit dhe Aseteve të Autoritetit Kontraktor, për çdo ndryshim të grafikut të shërbimit të rojeve në objekt, duke bërë shënimet përkatëse në librin e marrjes dhe dorëzimit të shërbimit.
6. SHPSF-ja për problematikat e konstatuara gjatë kryerjes së shërbimit njofton menjëherë Sektorin e Sigurisë të Aktivitetit dhe Aseteve të Autoritetit Kontraktor dhe zbaton të gjitha udhëzimet e dhëna për zgjidhjen e problemit.
7. SHPSF-ja kontraktore me personelin e rojes ndihmon Sektorin e Sigurisë të Aktivitetit dhe Aseteve të Autoritetit Kontraktor në rastet e rënies së zjarrit, përmytjeve, tërmeteve dhe pandemisë në objektet në ruajtje.
8. SHPSF-ja kontraktore siguron që i gjithë dokumentacioni i mbajtur që ka lidhje me aktivitetin dhe asetet e Autoritetit Kontraktor të dorëzohet pranë Sektorit të Sigurisë.
9. SHPSF-ja siguron që personeli i rojës të jetë i paraqitshëm me uniformë të rregullt e të plotë sipas stinës, të pastër dhe të hekurosuar.

-
10. SHPSF-ja kontraktore pajis me armë çdo vendroje në objektet e Autoritetit Kontraktor, sipas përcaktimeve të ligjit 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike" dhe ligjit nr.74/2014 "Për Armët".

Roja ka për detyrë:

1. Të kërkoj dhe të zbatoj me korrektësi rregullat e brendshme të Autoritetit Kontraktor.
2. Të zbatojë porositë dhe urdhërat e përgjegjës të rojës dhe të Sektorit të Sigurisë të Aktivitetit dhe Aseteve.
3. Të komunikojë qartë, shkurt, me mirësjellje dhe zë të ulët në ambientet ku kryen shërbim.
4. Të zbatojë me korrektësi të gjitha rregullat e sigurimit teknik në objekt.
5. Të kryejë kontrollin fizik të vizitorëve, automjeteve dhe çantave të tyre.
6. Të mos lejojë futjen e personave dhe mjeteve të paautorizuara në objekt.
7. Të kontrollojë dhe rregjistrojë kartën e identitetit të çdo vizitori që kërkon të hyjë në objekt.
8. Të evidentojë hyrjen e vizitorëve, automjeteve dhe materialeve në librin përkatës.
9. Të mos lejojë hyrjen dhe daljen e materialeve pa dokumentin dhe pa njoftimin përkatës.
10. Për persona që paraqiten për çështje pune, të njoftojë paraprakisht recepsionin e Autoritetit Kontraktor ose shefin e Sektorit të Sigurisë të Aktivitetit dhe Aseteve.
11. Të ndalojë hyrjen e vizitorëve me armë, pajisje elektronike (laptop, celular, etj.) dhe materiale të tjera të ndaluara në objekt dhe njofton për prezencën e tyre Sektorin e Sigurisë të Aktivitetit dhe Aseteve.
12. Të sigurohet që çantat dhe sendet që ndalohen të hyjnë në objekt të mbyllen në kasetat e vendosura për këtë qëllim dhe që çelësi i kasetës të mbahet nga vizitori deri në përfundim të vizitës.
13. Të njoftojë përgjegjës të objektit për mosfunksionimin e ndriçimit të jashtëm të objektit.
14. Të njoftojë shërbimin zjarrfikës në rast zjarri dhe të veprojë për shuarjen e tij deri në mbërritjen e shërbimit zjarrfikës.
15. Të kryejë bllokimin e ambientit dhe të autorit kur në objekt kryhen vepra penale dhe njoftojë menjëherë Sektorin e Sigurisë të Aktivitetit dhe Aseteve të OST sh.a. dhe organet kompetente.
16. Përdorimi i forcës vetëm në rastet e kundërshtimit me forcë të punonjës të shërbimit gjatë kryerjes së detyrave të tij.
17. Përdorimi i armës vetëm në bazë të ligjit nr 72/2014 "Për përdorimin e armëve të zjarrit".
18. Të bashkëpunojë ngushtë me Sektorin e Sigurisë të Aktivitetit dhe Aseteve të OST sh.a. dhe Policinë e Shtetit.
19. Para marrjes së shërbimit, kontrollon objektin në prezencë të rojes dorëzuese dhe për mangësitë e konstatuara njofton përgjegjës të rojeve dhe atë të objektit, duke bërë shënimet përkatëse në librin e shërbimit.
20. Për marrjen e detyrës sipas grafikut paraqitet 15 minuta para. Atij i ndalohet largimi nga vendi i kryerjes së shërbimit pa u zëvendësuar dhe pa njoftimin e përgjegjës të rojës.
21. Të monitorojë pamjet e siguruar nga sistemin i vëzhgimit me kamera, aty ku i është dhënë aksesimi për këtë qëllim.
22. Të njoftojë Sektorin e Sigurisë të Aktivitetit dhe Aseteve të OST sh.a. dhe përgjegjës të n/stacionit, për çdo defekt në kamerat dhe bën shënimin në librin e marrjes dhe dorëzimit të shërbimit duke shënuar kohën e defektit dhe kohën e njoftimit të këtij defekti.
23. Të mos lejojë heqjen apo zëvendësimin e kamerave të sigurisë pa autorizim të shefit të Sektorit të Sigurisë të Aktivitetit dhe Aseteve të OST sh.a.
24. Për probleme urgjente të shërbimit mund të përdorë mjetet e ndërlidhjes së objektit.
25. Rojas i ndalohet ndërrimi i shërbimit pa miratimin e përgjegjës të rojës dhe njoftimin paraprak të Sektorit të Sigurisë të Aktivitetit dhe Aseteve të OST sh.a.
26. Rojas i ndalohet futja dhe qëndrimi në ndërtesat e objektit në ruajtje përjashtuar rastet për zbatimin e detyrës së tij.
27. Rojas i ndalohet të konsumojë pije alkoolike para dhe gjatë shërbimit, të flejë gjatë shërbimit.

28. Rojes i ndalohet kategorikisht nxjerrja e armatimit jashtë objektit.

Në vendroje duhet të jenë këto dokumenta:

1. Karta e Identitetit e personelit të shërbimit të rojës.
2. Procedurat Standarte të Hyrje-Daljeve në OST sh.a. (sekretuar SSAA)
3. Rregullorja e brendshme SHPSF-së. (sekretuar SHPSF)
4. Libri i marrjes dhe dorëzimit të shërbimit në vendroje. (sekretuar SHPSF)
5. Libri i administrimit të armatim-municionit. (sekretuar SHPSF)
6. Libri i hyrje - daljeve të vizitorëve, automjeteve dhe materialeve. (sekretuar SSAA)
7. Grafiku i shërbimit.
8. Inventari i materialeve që ndodhen në objekt. (sekretuar NJO)
9. Lista e automjeteve që lejohen të hyjnë në objekt. (sekretuar NJO)
10. Numrat telefonik të Emergjencave, të Policisë së Shtetit, shërbimit Zjarrfikës, Ndihmës së Shpejtë, Sektorit të Sigurisë të OST sh.a. dhe të përgjegjësit të objektit.
11. Skema e ruajtjes dhe e organizimit të shërbimit për sigurinë e objektit, e miratuar nga Policia e Shtetit,
12. Dokumentat e punonjësit të shërbimit të ruajtjes dhe të sigurisë:
 - a. Çertifikatë për punonjësin e shërbimit në fushën e veprimtarisë së shërbimit privat të sigurisë fizike lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë së Shtetit.
 - b. Autorizim për përdorimin e armës nga Drejtoria Vendore e Policisë së Shtetit.
 - c. Dëshmin e kualifikimit për sigurimin teknik.

Roja duhet të jetë i pajisur me:

1. Uniformë të rregullt me shenja dalluese.
2. Armë (brezi ose krahu) (nga 1 për roje).
3. Shkop gome/Elektroshok (nga 1 për vendroje)
4. Pranga me çelës (nga 1 për objekt).
5. Elektrik dore (nga 1 për vendroje).
6. Mushama (nga 1 për vendroje).

III. Autoriteti Kontraktor:

1. Drejtuesi i Njesisë Operative dhe përgjegjësi i n/stacionit kanë për detyrë konstatimin e prezencës të personelit të shërbimit të SHPSF-së në NJO dhe n/stacion.
2. Drejtuesi i Njesisë Operative dhe përgjegjësi i n/stacionit kanë për detyrë pajisjen me materialet e nevojshme të punës në vendroje në NJO dhe n/stacionet përkatëse.
3. Drejtuesit e Njësive Operative të OST sh.a., në bazë të informacionit të përgjegjësve të n/stacioneve, për çdo shërbim të munguar njofton menjëherë Sektorin e Sigurisë të Aktivitetit dhe Aseteve të OST sh.a. dhe harton Aktin e Refuzimit të Pranimin të shërbimit.
4. Sektori i Sigurisë të Aktivitetit dhe Aseteve të OST sh.a. do të monitorojë zbatimin e detyrimeve kontraktore nga Drejtuesit e Njësive Operative dhe përgjegjësit të n/stacionit, dhe në rast të konstatimit të neglizhencave dhe shkeljeve informon Administratorin e OST sh.a.
5. Sektori i Sigurisë të Aktivitetit dhe Aseteve të OST sh.a. kontrollon kryerjen e shërbimit të ruajtjes dhe të sigurisë konform kontratës dhe rregullave të brendshme të OST sh.a., mban Proçesverbal Konstatimi duke lënë një kopje në objekt, njofton kontraktorin me qëllim eliminimin e menjëhershëm të mangësive të konstatuara dhe raporton te Administratori i OST sh.a. mbi problematikën e vërejtur dhe masat e marra.
6. Sektori i Sigurisë të Aktivitetit dhe Aseteve të OST sh.a. kur konstaton se këto mangësi nuk janë rregulluar brenda 15 ditëve, miraton pjesërisht Akt – Pranimin mujor të shërbimit dhe vendos mospagesën e muajit për shërbimin e munguar. Autoriteti kontraktues njoftohet me shkrim që brenda 15 ditëve të ardhshme të eliminojë të gjitha mangësitë.

7. Sektori i Sigurisë të Aktivitetit dhe Aseteve të OST sh.a. kur nga kontrollet e ushtruar konstaton se këto mangësi nuk janë rregulluar brenda 15 ditëve, nuk miraton Akt – Pranimin mujor të shërbimit dhe i propozon Administratorit të OST sh.a., vazhdimin e procedurës për prishjen e Kontratës.
8. Drejtoria e Shërbimit të Teknologjisë të Informacionit e OST sh.a., është përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe riparimin e sistemit të vëzhgimit me kamera si dhe ruajtjen e imazheve filmike në NVR/Server për të gjitha objektet e OST sh.a. ku janë vendosur.
9. Sektori i Sigurisë të OST sh.a., është përgjegjës për kontrollin e sistemit të vëzhgimit me kamera dhe pamjeve filmike të rregjistruara dhe të ruajtura për të gjitha objektet e OST sh.a.
10. Çdo ndryshim i skemës së vendosjes së kamerave kryhet nga Drejtoria e Shërbimit të Teknologjisë të Informacionit me kërkesë të Sektorit Sigurisë të Aktivitetit dhe Aseteve të OST sh.a.
11. Drejtoria e Shërbimit të Teknologjisë të Informacionit në bashkëpunim me Sektorin e Sigurisë të OST sh.a., hartojnë skemen e vendosjes së sistemit të vëzhgimit me kamera dhe kërkojnë miratimin e saj nga Drejtoria Vendore e Policisë së Shtetit ku ndodhen objektet e OST sh.a.

Vlerësimi për vendosjen e vendrojeve në objektet e shoqërisë OST sh.a. bazohet në:

- Strategjinë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë
- Udhëzimet e Komisionit të Sigurisë Kombëtare pranë Kuvendit të Shqipërisë.
- Ligjin nr.45 datë 18.07.2019 `Për Mbrojtjen Civile``
- Ligjit nr.19/2016`Për Masat Shtesë të Sigurisë Publike``
- Ligji nr.75/2014`Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike``
- Rregullore e Brendshme e Ushtrisë, Kapitulli ``Shërbimi i Rojës``

Vendosja e vendrojeve është bazuar edhe nga vlerësimi i aktivitetit që kryejnë rajonet e ekonomike që mbulojnë, vendodhja dhe pozita gjeografike e tyre, madhësinë e territorit të objekteve që varion nga 4 200 m² - 80 700 m², llojin e rrethimit, distancat nga stacionet e Policisë Vendore dhe qendrat e banuara, historiku i ngjarjeve të ndodhura në objektet e OST sh.a.

Shërbimi do të kryhet në **37 vendroje, me 184.26 roje** (me koeficient 4.98 roje për vendroje) do të bëhet me tre turne (24 orë) në 7 ditë të javës në objektet si mëposhtë:

OBJEKTET	Numri i Vend-Rojeve	Koeficienti i rojeve per çdo vendroje	Numri i Rojeve
LOTI I			
N/ST Fierzë	2	4.98	9.96
N/ST Koman	2	“	9.96
N/ST Vau Dejës	2	“	9.96
N/ST Koplik	2	“	9.96
N/ST Burrel	2	“	9.96
N/ST Shumat	2	“	9.96
Total loti 1	12	“	59.76
LOTI II			
N/ST Tirana 1	2	4.98	9.96
N/ST Tirana 2	2	“	9.96
N/ST Sharrë	1	“	4.98
N/ST Rrashbull	2	“	9.96
NJ.M.T	1	“	4.98
Zyrat Qendrore OST sh.a.	3	“	14.94
N/ST Elbasan 1	2	“	9.96
N/ST Elbasan 2	2	“	9.96

Magazina Elbasan	2	“	9.96
N/ST Zemblak	2	“	9.96
N/ST Fier	2	“	9.96
N/ST Babice	2	“	9.96
Magazina Kuçovë	2	“	9.96
Total loti 2	25	“	124.5
TOTALI	37	“	184.26

Shënime:

- i. Në mbështetje të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjitha rastet kur në dokumentet e tenderit përmendet “marka” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij”.
- ii. Kudo në Dokumentet e Tenderit ku citohen standardet ndërkombëtare, cilësimet ekuivalente do të pranohen nga një institut vendor.

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 *Licencë e shoqërisë për ushtrimin e aktivitetit të “Sherbimit të ruajtjes dhe/ose sigurisë fizike”, nënkategoria 1.3.A “Sigurimi fizik i objekteve shtetërore e private si dhe veprimtarive social kulturore, sportive, fetare e politike”, lëshuar në baze të Ligjit nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, nga QKL.*

2.1.2 *Certifikatë e drejtuesit teknik të subjektit, e vlefshme për ushtrimin e veprimtarisë së ruajtjes dhe të sigurisë fizike për nënkategorinë 1.3.A, lëshuar në baze të Ligjit nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” dhe Udhezimit të Ministrit të Brendshëm nr.130, date 05.03.2018.*

2.1.3 *Certifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave në baze të Ligjit nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, nënkategoria 1.3.A, për të paktën 185 (njqind e tetëdhjetë e pesë) punonjës shërbimi, të lëshuara nga Drejtorite e Vendore Policisë ku kryhet shërbimi, ndare në lote: Loti I 60 (gjashtëdhjetë) punonjës shërbimi ndërsa Loti II 125 (njqind e njetzet e pesë) punonjës shërbimi.*

2.1.4 *Certifikate e titullarit të subjektit, e vlefshme për ushtrimin e aktivitetit në fushën e veprimtarisë së shërbimit privat sigurisë fizike, lëshuar në baze të Ligjit nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” dhe Udhezimit të Ministrit të Brendshëm nr.130, date 05.03.2018, nënkategoria 1.3.A.*

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, të paktën 400,000,000 (katerqind milion) Leke.*

-
- Kur ofertohet per Lotin I-re duhet te jete ne nje vlere te pakten prej 100,000,000 (njqind milion) Leke.
 - Kur ofertohet per Lotin II-te duhet te jete ne nje vlere te pakten prej 300,000,000 (treqind milion) Leke.

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e siperpermendura dhe kopje të certifikuara të bilanceve ku të paktën në dy bilance të fundit, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete realizuar gjate tri viteve te fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kontrata te ngjashme ne nje vlere te pakten prej 150,000,000 (njqind e pesedhjete milion) Lekë pa TVSH.

- Kur ofertohet per Lotin I-re duhet te jete ne nje vlere te pakten prej 50,000,000 (pesedhjete milion) Leke.
- Kur ofertohet per Lotin II-te duhet te jete ne nje vlere te pakten prej 100,000,000 (njqind milion) Leke.

Lidhur me kete pike:

Kur OE ka realizuar kontrata me nje ent publik, kerkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqes Aktin e Miratimit të Qendrës së Kontrollit, leshuar nga Drejtorite Vendore te Policise se Qarqeve ku ndodhen objektet ku kryhet sherbimi, ne baze te nenit 22 te Ligjit nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” dhe Udhëzimit të Ministrisë të Brendshme nr.130, date 05.03.2018 “Per funksionimin e sherbimit privat te sigurise”.

2.3.3 Operatori ekonomik te paraqes Vertetim performance leshuar jo me pare se 30 dite nga dita e hapjes se ofertave, nga Drejtorite Vendore te Policise se Qarqeve ku kryhet sherbimi, ku të jepet informacioni si me poshte:

- Numri i punonjesve te sherbimit te certifikuar konform Ligjit nr. 75/2014, “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, duhet te jete jo me pak se 185 (njqind e tetedhjete e pese):
 - Loti I - 60 (gjashtedhjete) punonjes sherbimi te certifikuar.
 - Loti II - 125 (njqind e njezet e pese) punonjes sherbimi te certifikuar.
- Per numrin e armeve, i cili duhet te jete jo me pak se 37 (tridhjete e shtate) arme krahu:
 - Loti I - 12 (dymbedhjete) arme krahu.
 - Loti II - 25 (njezet e pese) arme krahu.

-
- *Per numrin e punonjesve te sherbimit te pajisur me autorizim per mbajtje arme, jo me pak se 40 punonjes sherbimi per Lotin I, dhe jo me pak se 84 punonjes sherbimi per Lotin II.*
 - *Qe ka grup te gatshem punonjesisht per verifikim te sinjaleve te alarmit.*

